

**Nr. Prot.xx/B/20****Nr. i Regjistrimit: 4x**

**DRAFT RREGULLORE**  
**PËR**  
**PAGESAT PËR MBIKQYRJEN E TREGUT TË**  
**KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE SHËRBIMEVE POSTARE**

Kjo rregullore është nxjerr në bazë të nenit 10 paragrafi 4, nenit 27, paragrafi 1), 2), 3) dhe 4), neni 81 paragrafi 1) dhe neni 83 paragrafi 1), të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si - LKE*); neni 28 të Ligjit Nr. 06/L-038 për Shërbime Postare (*tutje referuar si - LSHP*) dhe neni 5 paragrafi 2), 3), 4) dhe 5), neni 7 dhe neni 8 të Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

**Neni 1**  
**Fushëveprimi dhe Qëllimi i kësaj Rregulloreje**

- 1.1 Kjo rregullore përcakton nivelin e pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, dhe tregut të shërbimeve postare, të cilën pagesë duhet ta përmbushin ndërmarrjet e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe atë që ofrojnë shërbime postare.
- 1.2 Qëllimi i kësaj rregulloreje është që me anë të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut, sipas nivelit të llogaritur mbi bazën e kësaj rregulloreje, të garantohet financimi i nevojshëm për mbulimin e kostove administrative të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si -Autoriteti*) për ushtrimin e veprimtarisë si organ kompetent në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.
- 1.3 Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha ndërmarrjet, të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike dhe ato, të cilat ofrojnë shërbime postare e që kualifikohen sipas nenit 3.1 të kësaj rregulloreje.

**Neni 2**

## Përkufizimet

- 2.1 Kuptimi ose definicioni i cilësdo fjalë, frazë apo shprehje sipas ligjit gjithashtu do të jetë i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë rregullore.
- 2.2 Termat dhe shprehjet që pasojnë do të kenë këtë kuptim:
- a) **Ndërmarrje** – çdo person fizik dhe/ose juridik, ose një grup personash të bashkuar në bazë të kontrollit apo të varësisë, të cilët janë të përfshirë në një veprimtari të komunikimeve elektronike ose shërbimeve postare në Republikën e Kosovës ose veprimet e të cilave, nëse realizohen, kanë qëllim ose mund të kenë ndikim në aktivitetin ekonomik në Republikën e Kosovës;
  - b) **Mikro-ndërmarrjet** - janë ndërmarrje të cilat nuk tejkalojnë kufijtë e së paku dy(2) nga kriteret e mëposhtme:
    - pasqyra e pozitës financiare prej treqind e pesëdhjetë mijë euro (350,000.00 €);
    - qarkullimi neto prej shtatë qind mijë euro (700,000.00 €) ; dhe
    - numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: dhjetë (10).
  - c) **Ndërmarrjet e vogla** - janë ndërmarrje të cilat nuk janë mikro-ndërmarrje, por nuk tejkalojnë më shumë se dy (2) nga kriteret e mëposhtme:
    - pasqyra e pozitës financiare prej katër milion euro (4,000,000.00 €);
    - qarkullimi neto prej tetë milion euro (8,000,000.00 €); dhe
    - numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: pesëdhjetë (50).
  - d) **Ndërmarrjet e mesme** - janë ndërmarrje të cilat nuk janë as mikro-ndërmarrje e as ndërmarrje të vogla, por nuk tejkalojnë dy (2) nga kriteret e mëposhtme:
    - pasqyra e pozitës financiare prej njëzet milion euro (20,000,000.00 €);
    - qarkullimi neto prej dyzet milion euro (40,000,000.00 €); dhe
    - numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: dyqind e pesëdhjetë (250).
  - e) **Ndërmarrjet e mëdha** - janë ato ndërmarrje të cilat në datat e bilancit të tyre të gjendjes tejkalojnë të paktën dy(2) nga tre(3) kriteret e mëposhtme:
    - pasqyra e pozitës financiare prej njëzet milion euro (20,000,000.00 €);
    - qarkullimi neto prej dyzet milion euro (40,000,000.00 €); dhe
    - numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: dyqind e pesëdhjetë (250).
  - f) **Operator** - ndërmarrës që ofron, ose që është i autorizuar të ofrojë një rrjet të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese dhe shërbime postare;
  - g) **Pasqyra financiare** – përmbajnë:
    - pasqyrën e pozitës financiare në fund të periudhës;

- pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse për periudhën;
  - pasqyrën e rrjedhës së parasë për periudhën;
  - pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet; dhe
  - Shënimet, të cilat përbëjnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera sqaruese.
- h) Kosto administrative e Autoritetit** - shpenzime të Autoritetit, të cilat përbëjnë shpenzimet e operimit. Këto shpenzime përfshijnë: kategorinë e pagave dhe mëditjeve, kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, të cilat ndërlidhen me mbikqyrjen e tregut të Komunikime Elektronike në përputhje me nenin 81 të LKE dhe mbikqyrjen e tregut të shërbimeve postare në përputhje me nenin 28 të LSHP nga Autoriteti.
- i) Rrjet i Komunikimeve Elektronike** - sistemi i transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, pajisjet e komutimit ose rutinimit dhe resurset tjera, duke përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet mobile tokësore, sistemet e kabllave elektrike në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe të televizionit kabllor, pavarësisht nga tipi i informacionit të bartur;
- j) Shërbim i Komunikimeve Elektronike** - shërbimi që zakonisht ofrohet me pagesë, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e përdorura për transmetime radio-televizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përjashtuar shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetimin, duke përdorur rrjetet ose shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike.
- k) Shërbime postare** - shërbimet me pagesë që përfshijnë pranimin, përpunimin, transportin dhe shpërndarjen e dërgesave postare në rrjetin postar kombëtar dhe ndërkombëtar.

### Neni 3

#### Obligimet financiare të ndërmarrjeve

- 3.1 Të gjitha ato ndërmarrje, të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike dhe qarkullimi i të cilave është mbi njëqind mijë euro (100,000 €)), si dhe ndërmarrjet, të cilat ofrojnë shërbime postare janë të detyruar t'i paguajnë Autoritetit

pagesën vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

- 3.2 PAGESA për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, është pagesë e plotë vjetore dhe llogaritet në bazë të të ardhurave nga ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të paraqitura në bilancin vjetor të ndërmarrjes, në pajtim me nenin 27, paragrafi 2) të LKE, dhe nenin 28 paragrafi 4) i LSHP-së.
- 3.3 Ndërmarrjet janë të obliguara që të hyrat nga aktivitetet e komunikimeve elektronike t'i paraqesin të ndara për secilin aktivitet të notifikuar në ARKEP.
- 3.4 Ndërmarrjet, të cilat krahas aktivitetëve të specifikuar në paragrafin 3.2 të këtij neni, ofrojnë edhe aktivitete tjera, janë të obliguara që të ardhurat nga ofrimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare t'i pasqyrojnë të ndara nga të ardhurat tjera, me qëllim që të mos përfshihen në përlllogaritjen e pagesës vjetore të hyrat e realizuara nga aktivitetet tjera.
- 3.5 Në rast se ndërmarrjet nuk e bëjnë shpalljen e të hyrave konform kërkesave nga paragrafët 3.3 dhe 3.4, atëherë ARKEP do të tarifojë shumën e tërsishme të prezantuar në pasqyrat financiare.

#### **Neni 4**

#### **Dorëzimi i Raportëve Financiare**

- 4.1 Ndërmarrjet, e mesme dhe të mëdha, të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, janë të detyruara që të paraqesin pranë Autoritetit raportin e auditimit nga auditor (revizor) i pavarur, një firmë e auditimit apo ndonjë auditor ligjor të licencuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF).
- 4.1 Ndërmarrjet e vogla, të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike, janë të detyruara që të paraqesin pranë Autoritetit, pasqyrat financiare të nënshkruara nga kontabilisti i certifikuar së bashku me kopjen e certifikatës së lëshuar nga institucioni përgjegjës. Kopja e certifikatës duhet të jetë e certifikuar /nenshkuar nga kontabiliteti me mbishkrimin "kopja vlen vetëm për përdorim të kompanisë së ciles i perkasin pasqyrat financiare".
- 4.2 Mikro-ndërmarrjet të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike janë të detyruara që të paraqesin pranë Autoritetit, pasqyrat financiare (Bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave) të nënshkruara nga drejtori ekzekutiv apo pronari, si dhe formularin e deklaramentit të tatimit dhe pagesën e tatimit në fitim. Pasqyrat financiare duhet të përfshijnë së paku: totalin e asetëve dhe totalin e detyrimeve në datën e fundit të periudhës

raportuese, shpalosjen e të hyrave konform kërkesave nga paragrafët 3.3 dhe 3.4 dhe numrin mesatar të të punësuarve gjatë periudhës raportuese.

- 4.3 Ndërmarrjet, të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të dorëzojnë raportet financiare pranë Autoritetit, brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të vitit kalendarik, respektivisht deri me 31 Mars të çdo viti.
- 4.4 Ndërmarrjet, të cilat ofrojnë shërbime postare janë të detyruara që të paraqesin pranë Autoritetit, raport të pasqyrave financiare të audituara nga auditor (revizor) i pavarur, brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të vitit kalendarik, respektivisht deri me 31 Mars të çdo viti.
- 4.5 Pavarësisht paragrafëve 4.3 dhe 4.4 të këtij neni, ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha obligohen që deri më datë 31 Mars të çdo viti të dorëzojnë pasqyrat financiare të nënshkuara nga drejtori ekzekutiv apo pronari dhe zyrtari kryesor financiar apo personi përgjegjës për financa, kurse raporti i audituar financiar duhet të dorëzohet deri me datë 30 Qershor.

## **Neni 5**

### **Llogaritja e nivelit të pagesës vjetore**

- 5.1 Autoriteti deri më 10 Prill të çdo viti bënë llogaritjen e nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, për ndërmarrjet, të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike dhe shërbime postare.
- 5.2 Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrje të tregut llogaritet në përqindje nga njësitë (strukturat) përgjegjëse të Autoritetit në përputhje me formulat e specifikuara në nenet 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje.
- 5.3 Kjo pagesë nuk duhet të jetë më shumë se zero presje pesë përqind (0.5%) e të hyrave vjetore nga viti paraprak kalendarik për ndërmarrësit për komunikime elektronike dhe ofruesit e shërbimeve postare.
- 5.4 Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare llogaritet sipas formulës;

$$\text{NVP} = \frac{\text{KAV}}{\text{AV}} \times 100$$

**NVP** - Niveli i pagesës vjetore, i cili llogaritet ndaras për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare (në%)

**KAV** - Kosto administrative vjetore e Autoritetit e planifikuar për vitin koherent për mbikëqyrjen ndaras të secilit treg, që do të financohet nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

**AV** - Shuma e të ardhurave vjetore të vitit të mëparshëm, e realizuar ndaras nga veprimtaria e secilit treg, respektivisht:

- ndërmarrjeve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike për komunikime elektronike, të cilat kanë qarkullim mbi njëqind mijë euro (100,000 €) dhe
- ofruesve të shërbimit postar.

## Neni 6

### Llogaritja e pagesës për ndërmarrjet

- 6.1 Deri më 15 Prill të çdo viti, Autoriteti kryen llogaritjen dhe faturimin e pagesës për çdo ndërmarrje që ofron rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, si dhe shërbime postare, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
- 6.2 Pagesa vjetore që bënë ndërmarrja llogaritet sipas formulës:

$$PV = AV \times NVP$$

**PV** - Pagesa vjetore e ndërmarrjes për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare,

**AV** - Të ardhurat vjetore sipas pasqyrave financiare vjetore të vitit të mëparshëm të secilit:

- Ndërmarrës të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
- Ofrues të shërbimit postar.

**NPV** - Niveli i pagesës vjetore në përqindje ( %) për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, i llogaritur sipas formulës së përcaktuar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje.

## Neni 7

### Faturimi dhe Pagesa

- 7.1 Jo më vonë se data 16 Prill të çdo viti Autoriteti duhet t'i dërgojë ndërmarrjeve faturën e pagesës për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në formë elektronike ose fizike.

- 7.2 Ndërmarrja pas pranimit të faturës duhet të bëjë pagesën vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, pranë Autoritetit më së voni deri më datë 30 Prill të çdo viti.

## Neni 8

### Mos përmbushja e obligimeve

- 8.1 Mos dorëzimi pranë Autoritetit, i raportit vjetor financiar në përputhje me këtë rregullore, si dhe mos-pagesës të shumës për mbikëqyrjen e tregut nga ana e ndërmarrjes brenda afatit të përcaktuar me këtë rregullore përbën shkelje administrative.
- 8.2 Në rast të konstatimit të mos-përmbushjeve të referuara si në paragrafin 8.1 të këtij neni, atëherë Autoriteti do të veprojë në përputhje me nenin 101 të LKE, dhe nenin 58, paragrafi 3.3), nënparagrafi 3.3.2) të LSHP për shqiptimin e sanksioneve ekonomike.
- 8.2.1 Të gjitha ndërmarrjet, të cilat nuk kanë dorëzuar raportin vjetor dhe konstatohet se janë duke ushtruar veprimtar, përveç obligimit që i takon në bazë të kriterit për qarkullim sipas Rregullores, do t'u shqiptohet sanksioni ekonomik në vlerë prej 200 € (dyqind euro).
- 8.2.2 Të gjitha ndërmarrjet, të cilat nuk janë duke zhvilluar veprimtari, resektivisht nuk kanë raportuar dy herë radhazi, do t'iu revokohet Autorizimi dhe heqen nga Regjistri Zyrtar i Njoftimeve.
- 8.3

## Neni 9

### Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

- 9.1 Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Bordi i Autoritetit dhe mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e një rregullore tjetër.
- 9.2 Kjo Rregullore e shfuqizon Rregulloren Nr.18 për pagesa dhe mbikqyrje të tregut të komunikimeve elektronike të Miratuar me Vendimin Nr. 377 të Bordit të ARKEP (Ref. Nr. Prot. 020/B/13).

Prishtinë, xx/ xx/ 2020

Kryetari i Bordit të Autoritetit

---